

Ac.nr.4787/14

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Nora Bllaca Dula, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridiko kontestimore të paditëses Korporata Elektroenergjetike e Kosovës sh.a në Prishtinë, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar M.B., punëtor i së njëjtës, kundër të paditurit Kafiteria “...” me pronar R.I. nga Prishtina, Rr „ ” nr. 17, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1099/08, i datës 11.09.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1099/08 i datës 11.09.2014 vetëm sa i përket kamatës në shumën e gjykuar, ashtu që në këtë pjesë paditësit i gjykohet kamata të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë për mjetet e deponuara te qytetarëve në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 11.09.2014 e gjer në pagesën definitive, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadisë ankesa e të paditurit refuzohet si e pabazuar, dhe aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1099/08 i datës 11.09.2014, VERTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1099/08, i datës 11.09.2014, ka vendosur:

MIRATOHET E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit Korporata Elektroenergjetike e Kosovës sh.a në Prishtinë, dhe DETYROHET i padituri Kafiteria “...” R.I. nga Prishtina, që paditësit në emër të borxhit për shpenzimet e energjisë elektrike për periudhën nga data 18.02.2005 deri me 02.11.2006, t’ia paguajë shumën prej 2.301,72 euro, me kamatë 3.5% nga data e marrjes së aktgjykimit, si dhe shumën prej 60 euro në emër të shpenzimeve të procedurës, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, duke e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurit aktgjykimi i goditur të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar ose aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Paditësi nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore në kuptim të nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, këtu paditësi Korporata Elektroenergjetike e Kosovës-Distrikti në Prishtinë në Gjykatën e shkallës së parë kundër debitorit, këtu të paditurit, kishte paraqitur propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit të besueshëm –Faturës Nr.90027332, e datës 18.10.2006, për pagesë borxhi në shumën prej 2,281.72 euro. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me aktvendimin Ekz.nr.499/08 i datës 10.11.2008, e lejon ekzekutimin e propozuar nga kreditori. Kundër aktvendimit për lejim të ekzekutimit, debitori brenda afatit ligjor paraqet kundërshtim, duke i kontestuar shkaqet për caktimin e përmbarimit të dhunshëm, me arsyetimin se borxhi për të cilin pretendon kreditori është krijuar në periudhën nga 1999-2004, periudhë kohore kjo kur debitori e ka pasur të djegur shtëpinë e tij, por edhe nga fakti se borxhi i kërkuar është parashkuar në kuptim të nënrit 378 të LMD.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të kundërshtimit të debitorit, më datë 16.04.2009 nxjerrë aktvendimin E.nr.499/09, më të cilin e shfuqizon aktvendimin për lejimin e ekzekutimit, ndërpret të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra dhe propozimin për përmbarim të kreditorit e trajton si padi të rregullt civile.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas rregullave të procedurës kontestimore, e cakton dhe mbanë seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën sipas propozimit të ndërgjygjësve nxjerrë dhe administron provat nga shkresat e lëndës, më analizimin dhe vlerësimin e të cilave vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në ligj, me çka duke aplikuar normat ligjore të së drejtës materiale vendos me decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka bazuar në dispozitat ligjore të nenit 17 paragraf 1 dhe 261 paragraf 1 të LMD, duke arsyetuar se nga transaksioni i konsumatorit në emër të paditurit sipas shifrës DPR-202691 vërtetohet se paditësi nga data 18.02.2005 e gjer më datën 02.11.2006, ka shpenzuar energji elektrike në shumën e gjykuar prej 2.301,72 euro. Shpenzimin e energjisë elektrike në shumën e gjykuar nuk e ka kontestuar gjatë shqyrtimit kryesor as vet i padituri, i cili e ka pranuar se me palën paditëse me datën 12.01.2005 ka lidhë kontratë për pagesën e borxhit më këste, mirëpo për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike nuk ka mundur që ta paguaj borxhin e kërkuar nga paditësi. Gjatë shqyrtimit kryesor i padituri është pajtuar që lidhur me borxhin lëndor me paditësin të bënë pajtim gjyqësor për pagesën e borxhit më këste mujore në shumën prej 30 euro, për të cilin propozim të bërë nga i padituri nuk është pajtuar paditësi. Si rezultat i kësaj gjykata e shkallës së parë me tej ka arsyetuar se i padituri për shkak të mos pagesës së borxhit për energjinë elektrike të shpenzuar ka hyrë në raport detyrimor me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit, ndërsa i padituri cilësinë e debitorit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marrë duke u bazuar në dispozitivin ligjor të nenit 452.1 të LPK, e duke pasur parasysh suksesin e palëve në procedurën e

udhëhequr dhe shpenzimet të cilat paditësit si palë gjyqfituese i janë shkaktuar për ndjekjen e çështjes se tij ne gjyq.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë te drejtë dhe plotësisht, ku janë dhënë edhe arsye të mjaftueshme lidhur më faktet vendimtare rreth mënyrës së vendosjes të cilat kanë mbështetje të plotë ne provat shkresore dhe në ligj.

Pretendimi ankimor i te paditurit për shkeljet e pretenduara sipas ankesë se ushtruar , me arsyetimin se lidhur me periudhën kohore për të cilën ngarkohet me borxh nga ana e paditësit ka qenë ne gjendje te rëndë shëndetësore ku për shërimin e tij është dashur qe te paguaj shumën prej 5000 euro, ku për këtë shkak nuk ka pasur mundësi qe te kryer obligimet ndaj paditësit dhe nuk do te ketë mundësi qe edhe në të ardhmen ti kryej për shkak se me pagesën e kësaj shume do ti keqësohej dukshëm ekzistenca e familjes por edhe shëndetit të tij, sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit është pretendim i cili është pa ndonjë relevancë dhe ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar.

Ligjërisht kushtet e dobëta ekonomike të cilave ju referohet i padituri se i ka për momentin nuk paraqesin bazë ligjore për marrje te një vendimi ndryshe nga ana e kësaj gjykate, por të njëjtat do te mund te merreshin ne konsideratë vetëm ne rast se ndërgjygiësit gjatë fazës se procedurës kontestimore do te mund te arrin ndonjë pajtim gjyqësor për pagesën e borxhit ne këste mujore, dhe eventualisht edhe gjatë fazës se procedurës se përmbarimit të dhunshëm, në rast se organi përmbarues do te vinte ne përfundimin se ekzekutimi i menjëhershëm ne sendet dhe objektet e përmbarimit të te paditurit te cilat do te mund ti propozoheshin nga ana e paditësit, gjer ne shumën e gjykuar sipas aktgjykimit të ankimuar duke përfshirë edhe kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës, do te cenohej dhe rrezikohej dukshëm ekzistenca sociale e të paditurit dhe familjes se tij.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale gjeti se kamata e aprovuar në shumën e gjykuar është zbatuar në kundërshtim me dispozitën e nenin 277 të LMD, ngase kjo kamatë nuk është caktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë ligjore, me çka duke u nisur nga fakti se lidhur me kamatën e aprovuar aktgjykimi i Gjykatës të shkallës së parë është marr me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, i njëjti në këtë pjesë u dashtë të ndryshohet konform dispozitës së nenit 201 al. 1 pika d) të LPK.

Prandaj, nga të lartcekurat e në mbështetje të nenit 195.1 pika d) dhe e) e lidhur më nenin 200 dhe 201 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.4787/14, me datë 10.05.2018

Kryetari i kolegjit,
Qerim Ademaj, d.v.